



Seria "imageRUNNER ADVANCE DX C7700"

# LIDHJE TË SIGURTA, TRANSFORMIM DIXHITAL

TEKNOLOGJIA NOVATORE E SKANIMIT DHE SOFTUERËT INTELIGJENTË SHKOJNË KRAH PËR KRAH

E ardhmja e biznesit është dixhitale. "Canon imageRUNNER ADVANCE DX" është një gjeneratë e re pajisjesh inteligjente shumëfunktionale, projektuar për të mbështetur dhe përshpejtuar çdo hap të transformimit tuaj dixhital. Krijuar me "Canon imageRUNNER ADVANCE DNA", softuerët dhe teknologjia e fjalës së fundit shkojnë krah për krah në dixhitalizimin, automatizimin dhe optimizimin e proceseve të punës të orientuara drejt përmbajtjeve.

Seria "Canon imageRUNNER ADVANCE DX C7700" ofron pajisje inteligjente e të sigurta shumëfunktionale në A3 me ngjyra, me mundësi të përmirësuara shpejtësie, ngjyrash dhe finicionit, për ambiente tejet produktive, pa cenuar sigurinë. Teknologjia e re e skanimit ofron shpejtësi e saktësi të lartë, ndërsa "uniFLOW Online Express" – që vjen si standard – ofron lidhje në renë kompjuterike dhe menaxhim bazë të printimeve.



**LIDHJE NË RENË  
KOMPJUTERIKE**



**SIGURI**

**McAfee  
PROTECTED**



**PRODUKTIVITET**



**QËNDRUESHMËRI**



Canon uniFLOW Onjine  
Outstanding Cloud Output Management Solution

**Canon**

# Seria "imageRUNNER ADVANCE DX C7700"



## LIDHJE NË RENË KOMPJUTERIKE

- Skanoni dhe printoni dokumente kudo që të jeni me lidhjet e përmirësuara në renë kompjuterike, ofruar për praktikitet me formate të ripërdorshme printimi
- Softueri standard me bazë reje kompjuterike "uniFLOW Online Express" ofron një zgjidhje të vetme të integruar për të përmirësuar sigurinë e pajisjes dhe për të thjeshtuar menaxhimin e printimeve
- Platforma "Canon MEAP" optimizon proceset duke u integruar me zgjidhjet për menaxhimin e regjistrimit-realizimit të dokumenteve dhe aplikacioneve të ndryshme si "uniFLOW Online", "AirPrint", "Mopria", "Google Cloud Print" dhe "Canon PRINT Business"



## SIGURI

- Siguroni konfidencialitetin e informacionit dhe sigurinë në gjithë rrjetin me anë të IPsec dhe funksionit të murit mbrojtës
- Konfiguroni autentikimin e pajisjeve, autentikimin me dy elemente dhe kufizimet e funksioneve të pajisjeve, si për masat e sigurisë në pajisje, ashtu edhe me bazë reje kompjuterike
- Skanimi i enkriptuar i PDF-ve mundëson sigurinë e dokumenteve gjatë procesit të skanimit
- Kaloni në "uniFLOW Online" për printim të përmirësuar e të sigurt, printim portativ dhe printim nga vizitorët nga çdo pajisje
- Kombinimi i verifikimit të sistemit në nisje dhe i "McAfee Embedded Control Software" siguron që funksionin i pajisjes të mos cenohet kurrë nga modifikimi i firmuerit dhe i aplikacioneve, gjithçka në kohë reale.



## PRODUKTIVITET

- Skanimi i shpejtë, i cilësisë së lartë në 270 ipm (A4) me opsione zgjerimi të lidhjeve
- Ciklet e automatizuara të skanimit, ruajtjes dhe kërkimit rrisin efikasitetin dhe ulin gabimet njerëzore
- Mjetet e menaxhimit të pajisjeve si p.sh. iWMC ofrojnë kontroll të centralizuar mbi flotën e pajisjeve dhe menaxhim të printimeve
- Heqja automatike e fletëve të bardha gjatë skanimit, minimizon kohën e proceseve
- Formatet e ripërdorshme, emrat automatikë të skedarëve nga të dhënat e barkodeve, konvertimet e formateve të "Office", njohja e tekstit me bazë reje kompjuterike dhe pajisjes nëpërmjet IRIS mundësojnë përdorim të lehtë dhe procesim të shpejtë të dokumenteve



## QËNDRUESHMËRI

- Modifikojni cilësimet e printimeve në nivel pajisjeje për rezultate të përpikta skanimi
- Puna e qetë dhe zhurmat e zvogëluara të goditjes së letrës gjatë skanimit mundësohen falë teknologjive si regjistrimi dixhital dhe një strukturë e lëmuar e brendshme e vetëmbushës
- Proceset e automatizuara dhe të dixhitalizuara pakësojnë përdorimin e letrës për një zyrë pa letra
- Reduktimin mbetjet me skanimin e cilësisë së lartë, duke përfshirë drejtimin dixhital të figurës dhe qelqin e avancuar rezistent ndaj njollave

\* "uniFLOW Online" ofrohet si abonim me bazë reje kompjuterike për nxjerrje dokumentesh dhe administrim të regjistrimeve. Sipas nevojave të biznesit, përdoruesit mund të kalojnë në "uniFLOW Online" për të shkycur një larmi përfitimesh të avancuara, mes të cilave: Siguri më të lartë me mënyra autentikimi të përdoruesit. Procese të personalizuar pune për përmirësimin e produktivitetit. Mbetje më të pakta duke i anuluar punët që në pajisje. Një panel intuitiv në renë kompjuterike për të shfrytëzuar të dhëna në kohë reale. Kontroll më i madh mbi aksesin dhe përdorimin, për të reduktuar kostot e printimit.

## FAKTE TË SHPEJTA



- **Formati:** A3 me ngjyra
- **Kapaciteti i mbushjes me letër (maks.):** 7.050 fletë
- **Koha e nxehjes:** 4 sekonda e poshtë
- **Kapaciteti i finicionit:** Collate, Group, Offset, Staple, Saddle Stitch, Hole Punch, Eco Staple, Staple On Demand, Document Insertion, Z-fold, Half-fold, C-fold
- **Llojet e skedarëve të mbështetur:** PDF, EPS, TIFF, JPEG dhe XPS.
- **Opsionale:** "EFI Fiery" i integruar



- **Shpejtësia e printimit:** 65-80 fq/min (A4)
- **Shpejtësia e skanimit:** 270 ipm (A4)



- **Gjuhët e printimit:** UFRIL, PCL6, Adobe® PostScript 3™
- **Rezolucioni i printimit:** 1200x1200

- Lidhjet e përmirësuara në renë kompjuterike mundësojnë aksesin nga kudo në dokumente bashkëpunimi, me formate të ripërdorshme për administrim të lehtë
- Skanimi i saktë dhe i shpejtësisë së lartë mundësohet nga mekanizmi i ri i mbushjes së letrës dhe qelqi rezistent ndaj njollave
- Automatizimi i shkëlqyer e efikas do të thotë që dokumentet të skanohen, kërkohen dhe ruhen intuitivisht me aplikacione, si p.sh. "OneDrive", "SharePoint", "Concur" dhe "Dropbox"
- Softueri "McAfee Embedded Control" së bashku me funksione të tjera sigurie ofron një qetësi të plotë mendore dhe një mbrojtje 360° që mbulon dokumentin, rrjetin dhe pajisjen
- Menaxhimi i thjeshtuar i printimit mundësohet me cilësimet e printimit me administrim të centralizuar dhe analizë të përdorimit të pajisjes të ofruar përmes aplikacionit të brendshëm "uniFLOW Online Express"
- Puna e qetë e vetëmbushës së dokumenteve, konsumi i ulët i energjisë dhe emetimet e reduktuara ulin dhe impaktin mjedisor

## ZGJIDHJE ME POROSI PËR T'I BËRË BALLË ÇDO SFIDE

### BAZË

Kryejini veprimet rutinë në mënyrë të sigurt e të lehtë, me minimumin e harduerit, me softuer të integruar duke përfshirë UFOE dhe shërbime që ofrojnë mirëmbajtje dhe mbështetje tërësore për pajisjen.



### HARDUER



### SHËRBIME



### SOFTUER

### TË OPTIMIZUARA

Rrisni rendimentin me optimizime si opsionet e finicionit dhe modulet e sigurisë, si p.sh. shërbimi i heqjes së të dhënave. Zgjidhni mundësitë për zgjerimin e kapaciteteve në renë kompjuterike me anë të "uniFLOW Online", duke përfshirë skanim të avancuar direkt në llogarinë tuaj të "Google".

### ME POROSI

Zgjidhni opsione me porosi për çdo nevojë të biznesit, duke evituar barrën e menaxhimit të printimeve. Konsultohuni me ekspertët e "Canon" për të menaxhuar kërkesat tuaja të gjera me anë të opsioneve me porosit dhe shërbimeve të menaxhuara.

# Canon

Canon Inc.  
canon.com

Canon Europe  
canon-europe.com

Albanian edition

© Canon Europa N.V., 2020